

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Rashkaj, me procesmbajtësin Shani Canziba, sekretar juridik i kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit L. Th. nga fshati K., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.132/2018 të datës 22.03.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datën **05.07.2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.132/2018, e datës 22.03.2018.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 495, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari,

L. Th., nga i ati Q. dhe e ëma L., e lindur B., i lindur me datën ..., në Gjakovë, tani me vendbanim në fsh. K., Komuna e Rahovecit, me nr. personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me dt.10.01.2018, rreth orës 20:15 minuta, në rrugën Kramovik-Xërxë, pikërisht në fshatin Dejnë, Komuna e Rahovecit, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 120, lidhur me nenin 255 të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor, duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të ndodhë si pasojë e veprimit apo mosveprimit të tij, por me mendje lehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai mund ta ndaloj shkaktimin e saj dhe pasoja është shkaktuar, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës “Opel Vivaro”, me targa të regj.-...-..., duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe duke mos e mbajtur distancën e nevojshme të sigurisë në rrugë, shkakton aksident trafiku ku si pasojë me pjesën e përparme ballore të automjetit e godet në pjesën e pasme automjetin e markës “Chevrolet Evanda”, me targa të regjistrimit-...-..., të cilin e drejtonte M. H., me ç’rast përpos dëmeve materiale në automjete, lëndime të lehta trupore pësojnë të dëmtuarit M. H. dhe pasagjerja e tij L. H., të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. M. G. të dt.24.01.2018.

-Me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në kuptim të neneve 4, 41, 43 par.1 pika 1.3, 46 dhe 73 të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit, L. Th., në shumë prej **dyqind (200) Euro,** të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej dhjetë (10) ditësh, duke llogaritur çdo njëzet (20) Euro me një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të ekspertizës së komunikacionit rrugor shumë prej 40,88 Euro, në emër të ekspertizës së ekspertit mjeko-ligjor shumë prej 20 Euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej tridhjetë (30) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Të dëmtuarit: M. E. H. dhe L. E. H. nga fshati K. e M., Komuna e Rahovecit, udhëzohen që kërkesën pasurore ta realizojnë në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.132/2018 të datës 22.03.2018, kundër të akuzuarit L. Th. nga fshati K., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së. Po ashtu me aktakuzën e lartcekur Gjykatës i ka propozuar që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të marr aktgjykim me të cilin do ti shqiptoj të akuzuarit dënim me gjobë, pasi që konsideron se ekzistojnë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, si:

- Raporti i hetuesit mbi aksidentin e trafikut i dt.11.01.2018;

- Deklarata e të Pandehurit L. Th. e dhënë në St. Policor, në Gjakovë e dt.12.01.2018;
- Ekspertiza e Komunikacionit Rrugor, M. Eng. L. S. e dt.26.02.2018;
- Deklaratat e të dëmtuarëve M. H. dhe L. H. dhënë në Stacionin Policor në Gjakovë me dt.12.01.2018;
- Ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. M. G. e dt.07.02.2018;
- Foto-dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, si dhe shkresat tjera në lëndë, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj, duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata është e mendimit se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, u mor konform nenit 450 par. 1 dhe 2, nënparagrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
-Divizioni Penal-
P.nr.137/2018, me datë 05.07.2018

Sekretari juridik,
Shani Canziba

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ilir I. Rashkaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej tetë (8) ditëve, nga pranimi i të njëjtit. Pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.